

VENDIM
Nr.150, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË
LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET
EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.5, datë 26.1.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën e tretë rregullatore,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese, me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012, do të jetë 7.77 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe të KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani